



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail: contact@pallatirinise.com

www.pallatirinise.com

Në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), si dhe Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 13/30 maj 2012), dhe në përputhje me Statutin e N.P.L. Pallati i Rinisë sh.a. dhe Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Kryeshefja Ekzekutive e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, më datën 10.04.2025, mori vendim të PUBLIKOJË:

FTESE PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE

N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara, persona juridikë, të ofrojnë për marrje në shfrytëzim me qira lokalet afariste, zyrat dhe depot të cilat janë pronë e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Këto hapësira do t'u jepen me qira vetëm personave juridikë.

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m ²
1.	Zyre nr. 1 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhesë në pjesën jugore të sallës universale)	11.5 m ²	15.00 € Neto
2.	Zyre nr. 6 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhesë në pjesën jugore të sallës universale)	11.5 m ²	15.00 € Neto
3.	Zyre nr. 7 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhesë në pjesën jugore të sallës universale)	11.5 m ²	15.00 € Neto
4.	Zyre nr. 8 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhesë në pjesën jugore të sallës universale)	11.5 m ²	15.00 € Neto
5.	Zyre nr. 116/6 (që ndodhet në pjesën e hollit në mes të dy sallave, niveli i sheshit, pjesa perëndimore e Sallës Universale të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë)	48 m ²	5.00 € Neto
6.	Depo nr. 02 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)	54 m ²	6.17€ Neto
7.	Depo nr. 04 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)	70 m ²	6.17€ Neto
8.	Depo nr. 05 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)	60 m ²	6.17€ Neto
	DEPOT E SPORTIT		
9.	Depo (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të Sportit)	83.85 m ²	6.17€ Neto
10.	Depo e ish Sigurimit (në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)	28 m ²	6.17€ Neto

Kushtet e Përgjithshme:

1. Zyre nr. 1, nr. 6, nr. 7, nr. 8 dhe zyre nr. 116/6 (që ndodhen në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhesë në pjesën jugore të sallës universale). Çmimi fillestar për metër katror prej 15.00 € plus TVSH në muaj (në këtë çmim përfshihet mirëmbajtja/pastrimi i zyrës, shpenzimet e rrymës dhe sigurimi (në bazë të nenit 7, paragrafi 7.7 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies me qira të hapësirave kulturore, sportive dhe ekonomike dhe kontratave të shtëpisë nr. 1/883, data 22.06.2023).

2. Depot nr. 02, nr. 04 si dhe nr. 05 me çmim fillestar prej 6.17 € Neto, plus 10 % [Furnizimin me rrymë elektrike], [Furnizimin me ujë si dhe kanalizimi], [Mirëmbajtja dhe pastrimi, duke përfshirë edhe ndonjë pjesë të përbashkët], [Inkasimi për hedhurina], mirëmbajtja si dhe plus TVSH 18 % (Tatimi mbi vlerën e shtuar në bazë të ligjit në fuqi mbi tatimin mbi vlerën e shtuar).

3. Dy depot në hapësirat e korridorit të Sallës së Vogël të Sportit.

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm janë:

- Çmimi më i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
- Tarifa e aplikimit është 200.00 €, e cila do t'i kompensohet ofertuesit të zgjedhur me faturën e parë të qirasë. Tarifa e aplikimit nuk i kthehet ofertuesit të zgjedhur që tërhiqet nga kontrata për qira, ndërsa ofertuesit të pazgjedhur i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 €, e cila do të paguhet në këtë llogari: 1708020600000056.

Ofertuesi duhet t'i dorëzojë këto dokumente:

- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal (kopje).
- Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit (kopje).
- Çmimin e ofertuar për m², i cili duhet të jetë pa TVSH (Ofertë).
- Vërtetimin nga ATK-ja, që dëshmon se biznesi është aktiv.
- Fletëpagesën për aplikim.

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi ka pasur lokal, depo, apo zyrë me qira në Pallatin e Rinisë dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes.
2. Oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara.
3. Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në shpallje.

Personat juridikë që duan t'i vizitojnë lokalet, zyrat, si dhe depot e lartcekur, mund ta bëjnë këtë nga data: **10.04.2025** deri me datën **18.04.2025** nga ora **10:00** deri në ora **15:00**.

Për dy depot në hapësirat e korridorit të Sallës së Vogël të Sportit kanë të drejtë të ofertojnë vetëm Federatat si dhe Klubet Sportive, pasi që këto janë hapësira sportive.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datën: 18.04.2024, nga ora 10:00 deri në ora 12:00, në zyrën e arkivës së qiradhënësit N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr i lokalit, zyrës ose depos dhe kontaktet, si: email-i zyrtar dhe/apo nr. i telefonit.

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit më datën: 18.04.2025, nga ora 12:30, në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Drejtorisë së Pallatit të Rinisë në Prishtinë.

Kërkesa (aplikacioni) mund të kërkohej përmes email-it: contact@pallatirinise.com dhe në formë fizike në zyrën nr. 15, apo të shkarkohet nga faqja zyrtare e "Pallatit të Rinisë": <http://www.pallatirinise.com>.